

Kërkesë

Drejtuar: Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Për dijeni: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Objekti: Kërkesë për informacion

Të nderuar,

QENDRA PËR ADVOKIM SOCIAL, është një organizatë me bazë komunitare e fokusuar në fushën e advokimit dhe ndërtimit të një marrëdhënie sa më të fortë me komunitetin dhe përçimin e zërit të tyre drejt insitucioneve përgjegjëse. Që prej krijimit të organizatës është punuar në drejtim të përmirësimit të legjislacionit dhe akteve ligjore në fusha të ndryshme siç janë: strehimi social, punësimi, ligji i asistencës sociale, energjia elektrike dhe akte të tjera nënligjore që i vijnë në ndihmë fuqizimit të grupeve më në nevojë. Gjithashtu organizata prej dy vitesh tashmë ofron mundësinë e aksesimit të programeve të punësimit për të gjithë të interesuarit që duan të aplikojnë.

Në zbatim të ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit ” kërkojmë:

1. Informacion rreth viteve 2021-2022-2023, sa ka qenë buxheti i dedikuar për Programet e Nxitjes së Punësimit, konkretisht për Programet e Vetëpunësimit?
2. Gjatë tre viteve të fundit, specifikisht viteve të cituara më lart, sa ka qenë numri i përfituesve që kanë përfituar nga Programet e Vetëpunësimit?
3. A ka një datë zyrtare mbi hapjen e aplikimeve për vitin 2023 për Programet e Vetëpunësimit në mënyrë që të interesuarit të aplikojnë?

Duke ju falenderuar, mbetemi në pritje të përgjigjes nga ana juaj!

